

UDHËZIM
Nr.22, datë 29.5.2008

PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË PLANIFIKUARA PËR TRANSPORTIN E
MËSUESVE DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË E PUNOJNË LARG
VENDBANIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.486, datë 8.4.2008 “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit të tyre”,

UDHËZOH:

1. Transporti i mësuesve që punojnë larg vendbanimit të tyre në distancë mbi 4 km dhe kthehen brenda ditës, si dhe transporti i nxënësve të arsimit të detyrueshëm që ndjekin shkollën larg vendbanimit të tyre në distancë mbi 2 km, mbulohet nga fondet e Buxhetit të Shtetit të planifikuara për çdo drejtori arsimor rajonale/zyrë arsimor (DAR/ZA).

2. Shpenzimet dhe fondi limit për këtë shërbim prokurohen në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu II “Rregulla të përgjithshme të prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, nga çdo DAR/ZA për vitin kalendarik.

3. Për llogaritjen e fondit limit për këtë shërbim, nga çdo autoritet kontraktor ngrihet grupi i punës, i cili përcakton fondin limit për realizimin e këtij shërbimi, duke u mbështetur në të dhënat e mëposhtme:

- a) numri i mësuesve dhe nxënësve që udhëtojnë;
- b) numri i ditëve mësimore në javë;
- c) numri i javëve mësimore;
- d) çmimi mesatar i biletës ditore (vajtje-ardhje).

4. Për çmimin mesatar të biletës ditore grupi i punës mbështet në të dhënat e mëposhtme:

- a) çmimet mesatare të tregut,
- b) treguesit e botuar nga INSTAT, për indeksimin e çmimeve të shërbimit të transportit;
- c) çmimi mesatar i biletës për linjat interurbane, i miratur nga Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit.

5. Subjekti që merr përsipër kryerjen e këtij shërbimi, likujdohet çdo muaj për punën e kryer, në bazë të faturës tatimore, ku të ketë të përcaktuar numrin e mësuesve dhe të nxënësve që lëvizin çdo muaj.

6. DAR/ZA çdo muaj kërkon nga drejtorët e shkollave paraqitjen e vërtetimit për numrin e mësuesve dhe të nxënësve që lëvizin sipas linjave.

7. Në fund të çdo muaji, përpara pagimit të shërbimit, drejtori i DAR/ZA, përgjegjësi i burimeve njerëzore dhe specialisti i financës përpilojnë një aktrakordim, mbi numrin e mësuesve dhe të nxënësve, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga drejtoritë e shkollave dhe faturës së lëshuar nga subjekti që merr përsipër kryerjen e këtij shërbimi.

8. DAR/ZA në fillim të çdo viti kalendarik, përcaktojnë hartën e linjave dhe e miratojnë atë në këshillin e qarkut. Vendimi i këshillit të qarkut përmban distancën e linjave dhe kategorinë e rrugëve.

9. Për rastet e pamundësisë së zhvillimit të procedurës së prokurimit për ndonjë linjë të veçantë, pasi të jetë kryer e gjithë procedura e prokurimit, sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 10.1.2007

“Për rregullat e prokurimit publik”, DAR/ZA kryen pagesat për mësuesit dhe nxënësit, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga drejtorët e shkollave për numrin e mësuesve dhe të nxënësve që lëvizin sipas linjave. DAR/ZA harton listëpagesat për mësuesit dhe nxënësit dhe kalon pagesën për mësuesit në numrin e llogarisë bankare dhe për nxënësit pranë zyrave të postës shqiptare.

10. Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë DAR/ZA, në periudhën e planifikimit të numrit të mësuesve, në fillim të vitit shkollor kanë përgjegjësi për rritjen artificiale të lëvizjes së mësuesve, nga një njësi vendore në tjetrën.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Planifikimit Buxhetor, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Genc Pollo